



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1229/10 prot.

Datë 27.09.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 933/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Jonaid Myzyri    | Kryetar    |
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Anila Malaj      | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 27.09.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Dion - Al” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-22583-03-18-2022, me objekt: Loti 1 “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi*”, për *Qendrën Spitalore të Burgjeve*”, me fond limit 82.800.746 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 22.04.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK  
Rruga “Bardhok Biba”, Pallati “Trema”, Godina C, ap. Nr. 11,  
Kati 6, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë

**Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Dion - Al” SHPK  
Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla 2, Kati 2, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin*”

*e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.03.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-22583-03-18-2022, me objekt: Loti 1 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi’, për Qendrën Spitalore të Burgjeve”, me fond limit 82.800.746 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 22.04.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 22.04.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 30.05.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

|                           |                                 |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. “Dion - AL” SHPK       | 64.666.320 lekë, kualifikuar    |
| 2. “Nika” SHPK            | 72.057.570 lekë, skualifikuar   |
| 3. “Dajti Park 2007” SHPK | 81.906.000 lekë, kualifikuar    |
| 4. “KPL” SHPK             | 82.776.218,40 lekë, kualifikuar |

II.4. Në datën 02.06.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të Fituesit” për procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 09.06.2022 operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK, ka paraqitur njëkohësisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Dion - AL” SHPK.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.1229/2 prot., datë 09.06.2022 lidhur me kriteret për të cilat ky i fundit pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Dion - AL” SHPK, i kualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 1026 prot., datë 20.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1229/3 prot., datë 22.06.2022 me objekt “*Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 1 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore të Burgjeve”*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacion lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK dhe me shkresën nr. 955/3 prot., datë 20.06.2022, ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues mbi Vendimin nr.955/2 prot., datë 17.06.2022 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.9. Në kuadër të shqyrtimit të ankesës, me anë të shkresës nr.1229/4 prot., datë 18.08.2022, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktor, duke i kërkuar informacion si më poshtë:

*“...Komisioni i Prokurimit Publik është duke shqyrtuar ankesën nr.1229 prot., datë 09.06.2022 të operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK, i cili ngre pretendime për skualifikimin e operatorit ekonomik “Dion – Al” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-22583-03-18-2022, me objekt: Loti 1 ““Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Qendrën Spitalore të Burgjeve”, me fond limit 82.800.746 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 22.04.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.*

*Me anë të shkresës Nr.1026 prot., datë 20.06.2022, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.1229/3 prot., datë 22.06.2022, autoriteti juaj kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.*

*Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Dion – Al” SHPK, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkojmë nga institucioni juaj, të dorëzoni pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit tuaj, nga operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK, pas publikimit të njoftimit të fituesit, për këtë procedurë prokurimi.*

*Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, kërkojmë nga ana juaj të paraqisni pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionin e mësipërm, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese.*

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,”*

II.10. Nëpërmjet shkresës me nr. 1339/1 prot., datë 24.08.2022, protokolluar me tonën me nr. 1229/5 prot., datë 25.08.2022 me objekt “Dërgim dokumentacioni shtesë për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 1 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore të Burgjeve”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK, gjithsej 238 faqe, i cili fillon me nr. rendor. 2 dhe përfundon me nr. rendor 238 (134 fletë).

II.11. Në kuadër të shqyrtimit të ankesës, me anë të shkresës nr.1229/6 prot., datë 31.08.2022, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke i kërkuar informacion si vijon: *“...Në kuadër të shqyrtimit të një ankese, kërkojmë informacion mbi punonjësin Z.A.P, me NID xxxxxxxxxxxx, në lidhje me profesionin e ushtruar nga ky i fundit, për të gjitha vitet e punës së tij. Konkretisht, kërkojmë të na vini në dispozicion për secilin nga vendet e punës ku ky punonjës ka qenë i punësuar, kodin e profesionit sipas Listës Kombëtare të Profesioneve, si dhe periudhën e punësimit për secilin vend pune. Për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, si dhe për një shqyrtim më të plotë e objektiv të ankesës, lutemi të na dërgoni informacionin tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.”*

II.12. Për shkak të verifikimeve pranë organeve të tjera, me anë të shkresës nr.1229/7 prot., datë 31.08.2022, Komisioni i Prokurimit Publik ka njoftuar palët se: *“Lidhur me procedurën*

e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-22583-03-18-2022, me objekt: Loti 1 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Qendrën Spitalore të Burgjeve”, me fond limit 82.800.746 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 22.04.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115, pika 5 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet se: “5. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës Komisioni i Prokurimit Publik ka nevojë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta ose të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Afati për marrjen e vendimit nuk duhet të tejkalojë 30 ditë. Në çdo rast Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të vërë në dijeni palët”, ju bën të ditur të gjitha palëve të mësipërme, se për shkaqe të nevojshme për verifikim, në përputhje me dispozitën e sipërcituar, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.”

II.13. Nëpërmjet shkresës me nr. 14941/1 prot., datë 08.09.2022, protokolluar me tonën me nr. 1229/8 prot., datë 12.09.2022 me objekt “Kthim përgjigje”, institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka paraqitur informacionin e kërkuar nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me punonjësën A.P.

II.14. Në kuadër të shqyrtimit të ankesës, me anë të shkresës nr.1229/9 prot., datë 26.09.2022, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktor, duke i kërkuar informacion si më poshtë: “[...] Sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na informoni, nëse i keni kërkuar operatorit ekonomik të kualifikuar i pari “Dion – Al” SHPK, dokumentacionin provues në lidhje me Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në përputhje me pikën 6 të nenit 26, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe a është paraqitur ky dokumentacion nga operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK.

Nëse po, ju lutem të paraqisni pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit tuaj, nga operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK, në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. [...]”

II.15. Në përgjigje të shkresës së mësipërme, në datën 26.09.2022, autoriteti kontraktor me anë të postës elektronike, në emailin zyrtar të KPP-së është përgjigjur si më poshtë:

*“Përshëndetje!*

*Ne vijim te e-mail tuaj, mbi dokumentacionin e operatorit ekonomik "Dion-Al" ShPK, kualifikuar i pari ne proceduren e prokurimit me objekt: "Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi per Qendren Spitalore te Burgjeve", ju informojme si vijon:*

*Komisioni i Prokurimit Publik nepermjet shkreses nr.1229/4 prot., date 19.08.2022 (protokolluar me tonen nr. 1339 prot., date 22.08.2022) ka kerkuar dokumentacionin e paraqitur fizikisht nga ana e OE "Dion-Al" ShPK. Dokumentacion i cili eshte derguar nga ana e Organit Qendror Bleres nepermjet shkreses nr. 1339/1 prot., date 24.08.2022.*

*Persa kerkohet nga ana juaj, ju bejme me dije se gjithë dokumentacioni i paraqitur nga OE "Dion-Al" ShPK, është derguar ne rruge shkresore zyrtare me shkresen nr. 1339/1 prot., date 24.08.2022, perfshire edhe Formulari Permbledhes i Vetdeklarimit."*

II.16. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Dajti Park 2007" SHPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Dion – Al" SHPK me arsyetimin se "*Nuk plotëson pikën 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: a. Formulari Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 nuk është plotësuar siç duhet, ka mangësi në përshkrimin e të dhënave të aksionerëve, nuk ka paguar detyrimet e energjisë elektrike, nuk ka paguar detyrimet e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore të punonjësve, nuk ka paguar të gjitha taksat vendore për të gjitha ambientet ku ushtron veprimtarinë sipas ekstraktit historik të shoqërisë.*", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8, tek "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit", autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

*Ofertuesi deklaron se:*

*a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*

*c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*

*ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*

*d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;*

*dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;*

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

**Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.**

Ndërsa, në shtojcën 8, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1/a, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

III.1.2. Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

**Shtojca 9.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

| <b>Identifikimi</b>   | <b>Përgjigja</b> |
|---|------------------|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | -----            |
| Numri NIPT/et:  | -----            |

|                                     |       |
|-------------------------------------|-------|
| <i>Adresa postare:</i>              | ----- |
| <i>Qyteti / qyteti; Kodi postar</i> |       |
| <i>Përfaqësuesi (emri):</i>         | ----- |
| <i>Telefoni:</i>                    | ----- |
| <i>E-mail:</i>                      | ----- |

**B: DEKLARATË**

***Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)***

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*

- ***Informacione për nënkontraktorin***

| <b><i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i></b> | <b><i>NIPT –i</i></b> | <b><i>Përqindja e nënkontraktimit</i></b> | <b><i>Shërbimet /Mallrat e lidhura me to për t’u nënkontraktuar</i></b> |
|---|-----------------------|---|---|
|   |                       |   |   |
|   |                       |   |   |
|   |                       |   |   |

- ***Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik***

| <b><i>Emri (at) e subjekteve</i></b> | <b><i>NIPT-i</i></b> | <b><i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i></b> | <b><i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i></b> |
|--------------------------------------|----------------------|--|--|
|                                      |                      |  |  |
|                                      |                      |  |  |
|                                      |                      |  |  |

*Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet*



e kërkuara siç janë deklaruar.

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| <b><i>Deklarata</i></b>   | <b><i>Referencat (kur janë të zbatueshme)</i></b>  |
|---|--|
| <i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</i>   | <i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br/>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br/>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br/>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>  |
| <i>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</i>                              | <i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br/>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br/>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br/>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>  |
| <i>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</i><br><br><hr/><br><hr/><br><i>etj.</i><br><i>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për</i> | <i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br/>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br/>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br/>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]</i> |

|  |   |
|--|---|
| <p>ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>               |   |
| <p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>   | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br/>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br/>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br/>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |
| <p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>   | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br/>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br/>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br/>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |
| <p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>  | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br/>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br/>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br/>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |
| <p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br/><br/>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> | <p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br/>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br/>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br/>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p> |

|   |  |
|---|--|
| <p><i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</i></p>   | <p><i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</i></p> <p><i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i></p> |
| <p><i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i></p> <p><i>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i></p> | <p><i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</i></p> <p><i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i></p> |

**B: DEKLARATA**

***Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura***

| <b><i>Deklarata</i></b>   | <b><i>Përgjigje</i></b>     |
|---|-----------------------------|
| <p><i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</i></p> | <p>_____</p>                |
| <p><i>1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;</i></p>  | <p><b><i>Po [ ]</i></b></p> |

|   |                             |
|---|-----------------------------|
| <p>2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;</p>   | <p><b>Po [ ]</b></p>        |
| <p>3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;</p>  | <p><b>Po [ ]</b></p>        |
| <p>4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p>  | <p><b>Po [ ]</b></p>        |
| <p>5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës.</p> | <p><b>Po [ ]</b></p>        |
| <p>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>   | <p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p> |
| <p>7. Ofertuesi deklaron se është</p>   | <p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p> |

|   |                             |
|---|-----------------------------|
| <p><i>konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).</i></p>                     |                             |
| <p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p> | <p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p> |
| <p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>  | <p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p> |
| <p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes</p>   | <p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p> |

|   |  |
|---|--|
| <p>zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p> |  |
|   |  |

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

| <b>Deklarata</b>   |
|--|
| <p><i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</i></p>   |
| <p><i>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.</i> <p><i>Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.</i></p> <p><i>Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose</i></p> </li></ul> |

kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### **D: DEKLARATA**

##### **Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës**

| <b>Deklarata</b>  | <b>Përgjigje</b> |
|---|------------------|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:   |                  |
| 1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.  | Po [ ] Jo [ ]    |
| 2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. | Po [ ] Jo [ ]    |
| 3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në  | Po [ ] Jo [ ]    |

|  |  |
|--|--|
| <p><i>rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.</i></p> |  |
|  |  |

**Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

**A: DEKLARATË**

**Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:**

| <b>Deklarata</b>  | <b>Përgjigje</b>     |
|---|----------------------|
| <p><i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.</i></p> | <p>Po [ ] Jo [ ]</p> |
|   |                      |

**B: DEKLARATË**

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

| <b>Deklarata</b>  | <b>Përgjigje</b>   |
|---|--|
| <p><i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:</i></p> <p><i>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</i></p> | <p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p><u>Profili i punonjësve</u></p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/> |
| <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____ Vula _____</p> <p>Emri, Mbiemri, Firma _____</p>  |  |



Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

**Shënim:** Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Dion – AI” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur;

III.1.4. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

**2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.**

III.1.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

**“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

**dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;**

**e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;**

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

**6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

III.1.6. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK “Nuk plotëson pikën 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: a. Formulari Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 nuk është plotësuar siç duhet, ka mangësi në përshkrimin e të dhënave të aksionerëve, nuk ka paguar detyrimet e energjisë elektrike, nuk ka paguar detyrimet e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore të punonjësve, nuk ka paguar të gjitha taksat vendore për të gjitha ambientet ku ushtron veprimtarinë sipas ekstraktit historik të shoqërisë”, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Dion – AL” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili nga verifikimi konstatohet se është plotësuar sipas Shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit.

Referuar pikës 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, konstatohet se ligjvënësi ka parashikuar se “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”

Për këtë arsye, duke qenë se operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK është kualifikuar i pari në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK, për skuafikimin e operatorit ekonomik “Dion – Al” SHPK, me anë të shkresës nr.1229/4 prot., datë 18.08.2022, si dhe shkresës nr. 1229/9 prot., datë 26.09.2022 i kërkoi autoriteti kontraktor, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK, i renditur i pari.

Nëpërmjet shkresës me nr. 1339/1 prot., datë 24.08.2022, protokolluar me tonën me nr. 1229/5 prot., datë 25.08.2022 me objekt “Dërgim dokumentacioni shtesë për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 1 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore të Burgjeve”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK, gjithsej 238 faqe, i cili fillon me nr. rendor. 2 dhe përfundon me nr. rendor 238 (134 fletë). Gjithashtu, në datën 26.09.2022, autoriteti kontraktor me anë të postës elektronike, në emailin zyrtar të KPP-së është përgjigjur si më poshtë:

*“Përshëndetje!*

*Ne vijim te e-mail tuaj, mbi dokumentacionin e operatorit ekonomik "Dion-Al" ShPK, kualifikuar i pari ne procedurën e prokurimit me objekt: "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi per Qendren Spitalore te Burgjeve", ju informojme si vijon:*

*Komisioni i Prokurimit Publik nepermjet shkreses nr.1229/4 prot., date 19.08.2022 (protokolluar me tonen nr. 1339 prot., date 22.08.2022) ka kerkuar dokumentacionin e paraqitur fizikisht nga ana e OE "Dion-Al" ShPK. Dokumentacioni i cili eshte dërguar nga ana e Organit Qendror Bleres nepermjet shkreses nr. 1339/1 prot., date 24.08.2022.*

*Per sa kerkohet nga ana juaj, ju bejme me dije se gjithë dokumentacioni i paraqitur nga OE "Dion-Al" ShPK, eshte dërguar ne rruge shkresore zyrtare me shkresen nr. 1339/1 prot., date 24.08.2022, perفشire edhe Formulari Permbledhes i Vetedeklarimit.*

III.1.7. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet se operatori ekonomik “Dion – AL”, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, në seksionin mbi detyrimin për pagimin e energjisë elektrike ka deklaruar dokumentin Vërtetim debie, datë 29.03.2022, OSHEE-2022-5196352-UN, ndërkohë nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në zbatim të pikës 6 të nenit 26 të VKM, i ndryshuar, pas kualifikimit të tij, konstatohet se nuk është dorëzuar asnjë dokument që provon deklaratimet e mësipërme, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Gjithashtu, për sa i përket, deklaratimit të operatorit ekonomik “Dion – AL” SHPK, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, se përmbush detyrimin se ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, KPP, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në zbatim të pikës 6 të nenit 26 të VKM, i ndryshuar, pas kualifikimit të tij, nga operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK konstatohet, se nuk është dorëzuar asnjë dokument që provon deklaratimet e mësipërme.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e

gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër gjykojmë, se kërkesat e mësipërme, duhet të përmbushen nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatori ekonomik sipas shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit në respektim të nenit 82 të LPP dhe nenit 26 të VKM, i ndryshuar, dhe pas klasifikimit të ofertave, operatori ekonomik i kualifikuar i pari në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të VKM, i ndryshuar, pas kërkesës së autoritetit kontraktor, duhet të paraqesë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, me qëllim provueshmërinë e deklarimeve në formualin përmbledhës të vetëdeklarimit. Ndërkohë, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK, pranë autoritetit kontraktor, konstatohet se ky i fundit nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm me qëllim vërtetimin e deklarimeve të tij në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, për sa i përket pagesës së detyrimeve të energjisë elektrike dhe pagesës së detyrimeve të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore të punonjësve.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK qëndron.

III.2. Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, se operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK se “Nuk ka paraqitur dokumentet e kërkuara për Kuzhinierin dhe nuk është plotësuar Tabela sipas formatit me të dhënat e kërkuara”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, për Lotin 1, pika 2.3.4 e Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

4. *Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të ketë jo më pak se 9 (nëntë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:*

| <b>Nr.</b> | <b>Profesioni</b>                                  | <b>Numri i punonjesve</b> |
|------------|--|---------------------------|
| <b>1.</b>  | <i>Drejtues Teknik (Mercollog/Kimist/teknolog)</i> | <b>1</b>                  |
| <b>4.</b>  | <i>Kuzhinier</i>                                   | <b>2</b>                  |
| <b>5.</b>  | <i>Ndihmes Kuzhinier</i>                           | <b>4</b>                  |
| <b>6.</b>  | <i>Punonjes shpërdares ushqimesh/Shofer</i>        | <b>2</b>                  |
|            | <b>Total</b>                                       | <b>9 (nëntë)</b>          |

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

**a) Për drejtuesin teknik/(Mercollog/Kimist/teknolog) te paraqitet:**

- Diplomë ose certifikatë kualifikimi me profesion Merceolog/Kimist/Teknolog.
- Kontrate pune përkatëse.
- Librezë pune
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e - albania.
- Ne zbatim te akteve ligjore, drejtuesi i mesiperm nuk duhet te figuroje i dy punesuar ne sektor privat apo publik. Per kete Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise te paraqes deklarate perkatese.
- Drejtuesi nuk duhet te jete i angazhuar ne kontrata te tjera gjate periudhes se realizimit te objektit. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise.

**b) Për Kuzhinierin te paraqitet:**

- Diplome ose certifikatë kualifikimi.
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e – albania.

**c) Për ndihmes kuzhinier te paraqitet:**

- Kontrate pune.
- Librezë pune
- Duhet të ketë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e - albania.

**d) Për punonjesit per shperndarje ushqimi, te paraqitet:**

- Kontratë pune.
- Leje drejtimi mjetei kategoria – B.

➤ Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

| Nr. | Emer Mbiemer | Profesioni | Data e fillimit te marredhenieve te punes |
|-----|--------------|------------|---|
|     |              |            |   |

**Shënim 4.1:** Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale te punes si dhe diplomat/certifikatat e cdo punonjesi prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit përfundimtar.

**Shënim 4.2:**

Me qellim garantimin e gjithëpërfshirjes, për ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik për te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

**Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.**

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Dion – AI” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku në pjesën III, është plotësuar pika B “DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive;
- Deklaratë për stafin sipas tabelës:

| Nr. | Emer Mbiemer | Profesioni | Data e fillimit te marredhenieve te punes |
|-----|--------------|------------|---|
|-----|--------------|------------|---|

- Librezë pune në emër të znj. F.D, lëshuar në datë 01.09.2007;
- Librezë pune në emër të znj.M.P, lëshuar në datë 01.01.2008;
- Dokumentin “Vërtetim për bazën e vlerësuar”, në lidhje me pagesën e kontributeve të znj. F.D, lëshuar në datë 18.04.2022 nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- Dokumentin “Vërtetim për bazën e vlerësuar”, në lidhje me pagesën e kontributeve të znj. M.P, lëshuar në datë 18.04.2022 nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

III.2.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *I.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.2.4. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.2.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.6. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik ndër të tjera duhet të vërtetojë se ka në stafin e tij dy kuzhinier, për të cilin duhet të paraqesin, *Diplome ose certifikatë kualifikimi, Kontrate pune përkatëse, Librezë pune, Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të lëshuar nga e – albania.*

Në lidhje me punonjësit e mësipërm autoriteti kontraktor ka kërkuar plotësimin e një deklaratë sipas formatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit (nr; emër mbiemër; profesioni dhe data e fillimit të marrëdhënieve të punës). Gjithashtu në Shënimin 4.1 të pikës 2.3.4. të Kapacitetit teknik, autoriteti kontraktor ka parashikuar që *“Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës si dhe diplomat/certifikatat e çdo punonjësi pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar”*.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK *“Nuk ka paraqitur dokumentet e kërkuara për Kuzhinierin dhe nuk është plotësuar Tabela sipas formatit me të dhënat e kërkuara”*, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Dion – AL” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku në pjesën III, është plotësuar pika B *“DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive; Dokumentin “Deklaratë për stafin”*, ku konstatohet se janë deklaruar sipas formatit të tabelës të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, stafi i disponueshëm nga operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK, ku për pozicionin Kuzhinier janë deklaruar Znj. F.V dhe Znj M.P.

Gjithashtu, operatori ekonomik “Dion-Al” SHPK ka dorëzuar në SPE, dokumentacionin në lidhje me kuzhinierët, si Libreza pune dhe dokumentin *“Vërtetim për bazën e vlerësuar”*, në lidhje me pagesën e kontributeve nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, për secilën nga punonjëset.

Duke qenë se në dokumentet e tenderit, në Shënim 4.1 është përcaktuar se *“Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës si dhe diplomat/certifikatat e çdo punonjësi pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga*



*publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar*”, KPP, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, duke qenë se operatori ekonomik “Dion – AI” SHPK është kualifikuar i pari në këtë procedurë, me qëllim shqyrtimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, vendosi që me anë të shkresës nr. nr.1229/4 prot., datë 18.08.2022 dhe shkresën 1229/9 prot datë 26.09.2022, t’i kërkojë autoritetit kontraktor, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “Dion – AI” SHPK, për këtë procedurë prokurimi, me qëllim verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar mbi disponueshmërinë e dy kuzhinierëve.

Nëpërmjet shkresës me nr. 1339/1 prot., datë 24.08.2022, protokolluar me tonën me nr. 1229/5 prot., datë 25.08.2022 me objekt “*Dërgim dokumentacioni shtesë për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 1 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore të Burgjeve*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “Dion – AI” SHPK.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet se operatori ekonomik “Dion – AI” SHPK, në përmbushje të shënimit 4.1 në dokumentet e tenderit, për kuzhinieret znj.M.P, ka dorëzuar Kontratën individuale të punës, datë 04.01.2021 lidhur midis punëdhënësit “Dion – AI” dhe punëmarrësit znj M.P, me detyrë Kuzhinierë; Librezë pune, “Vërtetim për bazën e vlerësuar”, në lidhje me pagesën e kontributeve nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore si dhe Diplomë për mbarimin me sukses të kursit 3 mujor mbi bazat e kuzhinës italiane, lëshuar në datë 25.06.2010 nga Qendra e Gruas Hapa të Lehtë.

Ndërsa për punonjësin znj.F.V, ka dorëzuar Kontratën individuale të punës, datë 04.01.2021 lidhur midis punëdhënësit “Dion – AI” dhe punëmarrësit znj F.V, me detyrë Kuzhinierë; Librezë pune, si dhe “Vërtetim për bazën e vlerësuar”, në lidhje me pagesën e kontributeve nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) nga operatori ekonomik “Dion – AI” SHPK, si dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, KPP konstaton, se operatori ekonomik “Dion – AI” SHPK, në përmbushje të kriterit të mësipërm, në lidhje me disponimin e dy kuzhinierëve, për znj. F.V me pozicion kuzhinier nuk është paraqitur Diplomë apo dëshmi kualifikimi, siç kërkohet në dokumentet e tenderit.

Pra, operatori ekonomik “Dion – AI”, nuk përmbush kriterin e përcaktuar në lidhje me dy Kuzhinierë, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e kualifikimit në lidhje me to.

III.2.7. Komisioni rithekson, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti

kontraktor në dokumentat e tenderit sa i takon punonjësve të kërkuar, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Pra, në rastin konkret KPP gjykon se operatori ekonomik “Dion – AI” SHPK me dokumentacionin e paraqitur në SPE dhe dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nuk përmbush kriterin e vendosur në dokumentet e tenderit për kuzhinierët, pasi ka mungesë paraqitje të dokumentacionit në lidhje me to.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK, mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Dion – AI” SHPK, gjykojmë, se referuar arsytimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Dion – AI” SHPK, do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-22583-03-18-2022, me objekt: Loti 1 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Qendrën Spitalore të Burgjeve”, me fond limit 82.800.746 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 22.04.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Dion – AI” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomikë.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **K KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**